



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
KRYETARI**

VENDIM

Nr. 19058 / 12 / Datë 26.11.2015

PËR PLANIN VJETOR PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA NË SHËRBIMIN CIVIL

Në mbështetje të nenit 7/2 të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, nenit 18 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.108, datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” , si dhe Urdhërit të Kryetarit nr.12620, datë 14.09.2015 “Për miratimin e strukturës dhe organikës të Bashkisë së Tiranës”(i ndryshuar), si rezultat i krijimit të vendeve vakante në mënyrë të paparashikuar;

VENDOSA:

1. Për vitin 2015, në Shërbimin Civil të Bashkisë Tiranë do të rekrutohen në vendet vakante, 40 (dyzetë) nëpunës civil të kategorive dhe klasave të ndryshme si më poshtë:
 - 20 (Njëzetë) nëpunës civil, të Nivelit të Mesëm Drejtues;
 - 10 (Dhjetë) nëpunës civil, të Nivelit të Ulët Drejtues;
 - 10 (Dhjetë) nëpunës civil, të Kategorisë Egzekutive;
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

